



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr 1645/4 prot

Elbasan, më 29.06.2023

**VENDIM**

Nr 25 datë 29.06.2023

**Për**

**trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2022-2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, Bordi i Administrimit me vendim nr 33 datë 04.11.2022 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi", Relacionit të Administratorit datë 05.06.2023 "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2022-2023", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

- 1- Përfitojnë bursë financiare 4 studentë me kriterë të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur
- 2- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 8 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 3 studentë, sipas listës bashkëlidhur
- 4- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimit të kriterëve të studentëve, sipas listës për pikën 1 dhe 2 të mos zbatohet vendimarrja e përfitimit.
- 5- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DËRMISHI**

